



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/631  
Datë: 10/7/2023

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", mbështetur në Vendimin me nr. prot. 1/484, 16.6.2023 të Këshillit drejtues, shpall këtë:

### **THIRRJE**

**për mbështetje financiare të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", të cilët i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara**

#### **I. Kushtet e përgjithshme**

1. Mbështetja financiare do të jepet për studentët me aftësi të kufizuara, në lartësi deri në 450.00 €, varësisht numrit të përfituesve dhe buxhetit të miratuar nga Këshilli drejtues.
2. Të drejtë aplikimi për mbështetje financiare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
  - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
  - 2.2. T'i kenë të regjistruar të dy semestrat e vitit akademik 2022/23;
  - 2.3. T'i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.

#### **II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, aplikimin duhet të bëjnë përmes platformës elektronike SEMS në linkun: [studenti.uni-pr.edu](http://studenti.uni-pr.edu).
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
  - 2.1. Kërkesa për aplikim (Fletë aplikacioni), e cila shkarkohet pas aplikimit online përmes SEMS;
  - 2.2. Vërtetimi për statusin e studentit, si dëshmi për regjistrim të vitit akademik 2022/23;
  - 2.3. Dokumenti (certifikata) i lëshuar nga institucioni i autorizuar, me të cilin vërtetohet statusi i subjektit si person me aftësi të kufizuara.
3. Studenti obligohet që Fletë aplikacionin ta printoj dhe ta dorëzoj në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të thirrjes.

4. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë thirrje t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për përfitim të mbështetjes financiare, për miratim nga Këshilli drejtues.
5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave e bartin dekanët e fakulteteve.
6. Mbështetja financiare për vitin akademik 2022/23, ndahet për studentët e të gjitha niveleve dhe programeve të studimit, të cilët i përkatësin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.
7. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, të kontaktohet zyrtari i TI-së i fakultetit përkatës.

### III. Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun [studenti.uni-pr.edu](http://studenti.uni-pr.edu) hapet prej datës **11.7.2023** deri me datë **18.7.2023**, në orën **16:00**.
2. Ditën e parë, me datë **11.7.2023**, aplikimi elektronik do të funksionalizohet në orën **10:00**.

### IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të mbështetjes financiare dhe nuk janë përfshirë në listën e përfituesve, kanë të drejtë ankesë në afat prej dyzet e tetë (48) orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në zyrën e arkivit të UP-së (nr. 18), në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

### V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve dhe ueb faqet e fakulteteve, si dhe në ueb faqen e Universitetit: [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu).

